



**KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT**  
**ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE**

# **KODI ETIK I SJELLJES**

*Tiranë, Korrik 2023*



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

### I. QËLLIMI DHE OBJEKTI

Kodi Etik i Sjelljes do të shërbejë si një udhërrëfyes për veprimet e përditshme në punë, duke reflektuar standardin më të lartë të sjelljes së përshtatshme që duhet të shoqërojë sjelljen e çdo punonjësi, vullnetari, korrespondenti lokal, vëzhguesi/monitoruesi dhe eksperti të jashtëm të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, gjatë kohës së ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi (në emër dhe për llogari të KShH-së) si dhe në momentin e përfshirjes/angazhimit, në aktivitete të deleguara nga KShH, në fokus të misionit të organizatës.

Ky kod ka si qëllim përcaktimin e rregullave të sjelljes dhe etikës profesionale, që duhet të respektojnë dhe garantojnë subjektet e sipërcituara. Duke i mbështetur parimet udhëheqëse të Kodit Etik të Sjelljes, ne përpiqemi të krijojmë një shoqëri të drejtë dhe gjithëpërfshirëse ku të drejtat e njeriut respektohen dhe mbrohen.

### II. MISIONI YNË

Nëpërmjet veprimtarisë tonë, ne synojmë dhënien e kontributit në garantimin e respektimit të të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit të së drejtës, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme, në përputhje me Kushtetutën dhe me aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë. Ne punojmë për mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

## PARIMET UDHËHEQËSE

### Neni 1

#### Respekti për Dinjitetin Njerëzor

- a. Ne respektojmë dhe promovojmë të drejtat universale të njeriut të parashikuara në aktet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, udhëhequr nga standardet më të larta dhe më të mira të trajtimit human.
- b. Ne mbështesim dinjitetin dhe vlerën e qenësishme të çdo individi, pavarësisht nga raca, përkatësia etnike, ngjyra, gjuha, shtetësia, bindjet fetare, politike ose filozofike, identiteti gjinor, gjinia e orientimi seksual, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, pamja e jashtme e aftësinë së kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose çdo karakteristikë tjetër.



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- c. Ne i trajtojmë të gjithë individët me respekt, drejtësi dhe barazi, duke vlerësuar perspektivat dhe kontributet e tyre unike në organizatë e më gjerë.

### Neni 2

#### **Përgjegjësia dhe shërbimi në favor të interesit publik**

- a. Ne tregojmë kujdesin e duhur ndaj vlerave morale, fesë, zakoneve, traditave dhe kulturës së komuniteteve të cilave u shërbejmë.
- b. Në mbështetje të misionit dhe qëllimit të organizatës, ne ndërmarrim aktivitete në respektim të interesit të publikut të gjerë.
- c. Ne ndërmarrim dhe promovojmë veprimtari dhe sjellje që ndikojnë pozitivisht për nxitjen e rritjes së besimit të publikut në veprimtarinë e sektorit të shoqërisë civile.
- d. Ne ndërmarrim aktivitete, duke shfaqur ndjenjën e përgjegjshmërisë dhe kujdesit ndaj mjedisit.

### Neni 3

#### **Përfaqësimi i organizatës në publik**

Në aktivitete me natyrë publike, sikurse mund të jenë aktivitetet e KShH-së të aksesueshme nga publiku (trajnime, seminare, forume, etj), aktivitete të organizatave apo institucioneve të tjera ku KShH është e ftuar dhe kanë një audiencë, intervista në mediane dhe elektronike të dhëna për KShH, konferenca për shtyp, dhe aktivitete të ngjashme me to, ne:

- a. Marrim pjesë në këto aktivitete me delegim të Drejtorit Ekzekutiv.
- b. I përmbahemi misionit dhe veprimtarisë së KShH-së në thëniet dhe deklaratat tona në këto aktivitete..
- c. Tregojmë kujdes maksimal që deklaratat e dhëna në përputhje me germën b) të sipërcituar, të mos kenë apo të mos interpretohen mbi baza të arsyeshme, se kanë karakter politik, në favor apo disfavor të një partie apo lëvizje politike.

Tregojmë kujdesin maksimal për të qenë profesional në diskutimet dhe debatet tona në këto aktivitete.

### Neni 4

#### **Ndalimi i diskriminimit dhe sjelljes me natyrë denigruese e bullizuese**



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- a. Ne nuk diskriminojmë asnjë individ ose grup individësh bazuar në racën, përkatësinë etnike, gjininë, fenë, orientimin seksual, paaftësinë ose ndonjë karakteristikë tjetër të mbrojtur nga legjislacioni i posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.
- b. Ne promovojmë diversitetin dhe përfshirjen, duke nxitur një mjedis që krijon dhe frymëzon dallimet e qasjet e ndryshme.
- c. Ne kemi prioritet sigurinë dhe mirëqenien fizike dhe mendore të të gjithë individëve pjesëmarrës në aktivitetet tona, duke përfshirë stafin, vullnetarët, përfituesit dhe partnerët.
- d. Ne marrim masa për të parandaluar, trajtuar e ndëshkuar çdo formë ngacmimi, bullizimi, abuzimi, shfrytëzimi ose dhune.

### Neni 5

#### **Besnikëria ndaj organizatës**

- a. Ne përmbushim të gjitha përgjegjësitë kontraktuale në raport me KShH-në si gjatë afatit të parashikuar në kontratë dhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës. Të tilla mund të jenë rastet kur, pavarësisht nga largimi i punonjësit, organizata ka vështirësi në gjetjen e dokumentacion/informacionit që kanë qenë në përgjegjësi apo administrimin direkt të tij/saj, të rëndësishëm për mbarëvajtjen normale të veprimtarisë së saj si dhe kur i nënshtrohet proceseve të auditimit, inspektimeve nga organet tatimore/institucionet e tjera ligjzbatuese, kontrolleve nga donatori apo asambleja e organizatës.

### Neni 6

#### **Transparenca, Profesionalizmi, Përgjegjshmëria dhe Llogaridhënia**

- a. Ne i përmbahemi standardeve më të larta etike, duke treguar profesionalizëm, duke ruajtur integritetin, transparencën dhe llogaridhënien.
- b. Ne sigurojmë që veprimet dhe vendimet tona të udhëhiqen nga parimet e profesionalizmit, ndershmërisë, drejtësisë dhe përgjegjësisë.
- c. Ne garantojmë ndërveprimin e ndërsjellë me përfaqësues të entiteteve publike e private, publikun, donatorë, partnerë, përfitues in/direktë dhe palë të tjera të interesuara, nën udhëheqjen e parimit të transparencës, profesionalizmit dhe seriozitetit.
- d. Ne garantojmë aksesueshmëri dhe transparencë ndaj publikut, në informacionin bazë financiar, strukturën organizative, aktivitete dhe të dhëna që reflektojnë origjinën dhe përdorimin e burimeve financiare.
- e. Ne garantojmë dhe promovojmë përgjegjshmëri për veprimet dhe vendimet e organizatës, jo vetëm ndaj komunitetit të donatorëve dhe aktorëve institucionalë, por edhe ndaj



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

individëve të cilëve u shërbejmë, stafit dhe anëtarëve të stafit, organizatave partnere dhe publikut në përgjithësi.

- f. Ne jemi përgjegjës ndaj palëve të interesit, duke siguruar raportim transparent, përdorim të përgjegjshëm të burimeve dhe qeverisje efektive.

### Neni 7

#### **Integriteti individual dhe organizativ**

- a. Ne garantojmë se asnjë pjesë e të ardhurave financiare nuk ofrohet në dobi të drejtuesve, përfaqësuesve të organeve drejtuese e vendimmarrësve, stafit ekzekutiv, ose të ndonjë punonjësi tjetër privat, përveç kur justifikohet akordimi i kompensimit të arsyeshëm për shërbimet e ofruara për organizatën.
- b. Me veprimet dhe mosveprimet tona, ne garantojmë mos qenien pjesë, ose të qenarit nën kontroll apo administrim nga qeveria apo agjenci e ndërvarur qeveritare, apo parti/lëvizje me natyrë politike.
- c. Ne garantojmë përmbushjen e detyrimeve tona sipas legjislacionit vendas dhe atij evropian, duke respektuar parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit, ryshfetit dhe parregullsive apo paligjshmërive të natyrës financiare e jo vetëm.
- d. Ne promovojmë dhe garantojmë ruajtjen e pavarësisë e distancimin organizativ nga subjektet politike ose përfaqësues të tyre, si dhe nxisim vetë-qeverisjen e brendshme organizative.

### Neni 8

#### **Dhënia e pëlqimit dhe Privatësia**

- a. Ne zbatojmë dhe promovojmë pëlqimin e informuar nga individët, para se të grumbullojmë, përdorim ose përpunojmë informacion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
- b. Ne respektojmë privatësinë dhe konfidencialitetin e individëve, duke siguruar masa mbrojtëse të përshtatshme për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale, nëpërmjet nënshkrimit të deklaratave të konfidencialitetit dhe integritetit, si dhe zbatimin rigoroz të dispozitave të parashikuara në aktet e brendshme rregullatore.

### Neni 9

#### **Përfshirja dhe Demokracia Organizative**



## **KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT**

### **ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE**

- a. Ne garantojmë mirëfunksionimin e punës në grup dhe përshtatjen ndaj kërkesave e termave kontraktualë të referencës, në përputhje me secilin pozicion në organizatë.
- b. Ne garantojmë ndërtimin e marrëdhënieve të punës brenda organizatës, si dhe bashkëpunimit me të tretët, mbi baza të mirëkuptimit, respektit reciprok dhe solidaritetit.
- c. Ne angazhohemi dhe përfshijmë në mënyrë aktive njerëzit të cilëve ju shërbejmë, duke promovuar pjesëmarrjen e tyre domethënëse në proceset advokuese dhe vendimmarrëse.
- d. Ne i fuqizojmë individët të ushtrojnë të drejtat e tyre, duke inkurajuar përfshirjen e tyre aktive.
- e. Ne përqafojmë një kulturë të të mësuarit të vazhdueshëm, duke kërkuar të përmirësojmë praktikatat dhe rezultatet tona, nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese vendase, rajonale e ndërkombëtare.

#### **Neni 10**

##### **Shmangia e konfliktit të interesit**

- a. Ne nxisim dhe garantojmë prioritizimin e qëllimeve strategjike e misionit të organizatës, përpara interesave personale.
- b. Ne angazhohemi në kontribuimin në parandalimin, deklarimin dhe regjistrimin e trajtimit e rasteve të konfliktit real, të mundshëm, dhe në dukje të interesit, në frymën e akteve të brendshme rregullatore dhe përmbushjen e detyrimeve që burojnë prej tyre.
- c. Ne distancohemi nga përdorimi apo përfitimi nga funksioni organizativ, për të siguruar privilegje ose përfitime të veçanta për veten, familjarët apo të njohurit tanë.

#### **Neni 11**

##### **Dhuratat, favoret apo përfitimet e tjera**

- a. Ne distancohemi nga kërkimi apo marrja e dhuratave, favoreve apo çdo përfitimi tjetër, si dhe premtime për to, për veten, për familjen, të afërmit, persona apo organizatat me të cilat kemi marrëdhënie, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për kryerjen e një detyre të caktuar në funksion të rolit në organizatë.
- b. Ne promovojmë dhe nxisim praktikatat e njoftimit të menjëhershëm të strukturave përgjegjëse pranë organizatës, në rastet e tentativave për korrupsion apo kërkesave të padrejta e të paligjshme për favore apo privilegje.



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- c. Ne distancohemi nga realizimi i premtimeve private në emër të organizatës, personave me të cilët njihemi ose lidhemi nëpërmjet ose për shkak të funksionit/pozicionit në organizatë.
- d. Ne distancohemi nga përdorimi i funksionit/pozicionit në organizatë, ose krijimi i hapësirës për personat e tjerë të lidhur për përdorimin e tij, me synim nxitjen ose detyrimin e një personi tjetër për të pasur një përfitim financiar ose të çdo lloji tjetër me interes personal.

### **Neni 12**

#### **Bashkëpunimi dhe Rrjetëzimet**

- a. Në përputhje me misionin e KShH-së ne reflektojmë gatishmëri për të bashkëpunuar përtej kufijve të politikës, fesë, kulturës, racës dhe përkatësisë etnike, brenda parashikimeve të dokumenteve të brendshëm strategjikë organizativë, me organizata dhe individë që ndajnë vlera, parime dhe objektiva të përbashkëta.
- b. Ne nxisim partneritetet dhe bashkëpunimin me organizata të tjera vendase, rajonale dhe ndërkombëtare, aktorë institucionalë dhe palë të interesuara, duke njohur përpjekjet kolektive të nevojshme për të avancuar të drejtat e njeriut në vendin tonë, e më gjerë.
- c. Ne angazhohemi në dialog me respekt të ndërsjellë, duke vlerësuar perspektiva të ndryshme dhe duke punuar drejt qëllimeve të përbashkëta.

### **Neni 13**

#### **Paraqitja dhe standardet e jashtme të veshjes**

- a. Ne garantojmë përdorimin e veshjeve etike e serioze, brenda nivelit të domosdoshëm të pastërtisë, si përfaqësues të organizatës gjatë orarit zyrtar të punës dhe jashtë tij (në rastet e pjesëmarrjes në aktivitete në kuadër të organizatës). Veshja duhet t'i përgjigjet vendit dhe natyrës së punës së secilit rol në organizatë dhe jashtë saj (kur ka pjesëmarrje në misione monitoruese, trajnime, seminare, tryeza të rumbullakëta, takime me institucionet, konferenca, etj).
- b. Ne garantojmë informimin dhe respektimin e rregullave të parashikuara në Rregulloren e brendshme të zyrës, sipas së cilës konsiderohen veshje jo serioze përdorimi i veshjeve transparente ose të shkurtra, provokative në dukje, me stampime të pahijshme dhe që lejojnë të shihen pjesë të papërshtatshme (si psh intime) të trupit.
- c. Ne garantojmë mos konsumimin e pijeve alkoolike, dhe duhanit në ambientet e organizatës, gjatë kohëzgjatjes normale të punës.

### **Neni 14**



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

### Zbatimi efektiv i orarit të punës

- a. Ne garantojmë përdorimin në mënyrë efektive të orarit zyrtar të punës sipas Rregullores së Brendshme të organizatës, përveç rasteve kur përdorimi i tij realizohet për qëllime të tjera me autorizim nga ana e Drejtores Ekzekutive të organizatës.
- b. Ne distancohemi nga përdorimi i funksionit/pozicionit të punës për të penguar veprimtarinë e të tretëve ose për t'i dëmtuar ata për arsye personale.

### Neni 15

#### Dëmi ndaj organizatës

- a. Në parim, ne tregojmë një qasje të hapur për të bashkëpunuar me strukturat drejtuese dhe vendimmarrëse të organizatës, për ta zgjidhur me marrëveshje rastet kur organizata (KShH) ka pësuar një dëm (moral ose material) si rezultat i mosushtrimit të përgjegjësive dhe detyrave kontraktuale, mosbashkëpunimit luajal me kolegët, vartësit apo eprorët, mosvendosjes në dispozicion të një dokumentacioni/informacioni që lidhet me detyrat tona dhe është përgjegjësi e jona, apo administrimit dhe përdorimit të informacionit që disponojmë për shkak të detyrës që kemi në KShH, pa autorizim paraprak.
- b. Në rastet kur situata të tilla nuk zgjidhen me marrëveshje dhe mirëkuptim midis palëve, secila prej tyre ka të drejtë të drejtohet gjykatës, për të kërkuar dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Neni 19

#### Hyrja në Fuqi

- a. Brenda datës 30 Korrik 2023, stafi ekzekutiv i KShH-së nënshkruan deklaratën për marrjen dijani lidhur me dispozitat e këtij Kodi, sipas formatit tip të miratuar nga Drejtori Ekzekutiv. Për stafin e KShH-së, ky Kod hyn në fuqi, jo më vonë se dt. 30 Korrik 2023, pas miratimit të saj në Asamblenë e Përgjithshme të KShH-së.
- b. Për korrespondentët lokalë të KShH, afati për nënshkrimin e deklaratës së parashikuar në gërmën “b” zgjatet deri në dt.15 Shtator 2023. Data e nënshkrimit të deklaratës, individualisht nga secili korrespondent, përbën datën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi respektivisht për ta.
- c. Për vullnetarët dhe ekspertët e jashtëm, teksti i këtij Kodi bëhet pjesë aneksit shoqërues të kontratave të lidhura me ta pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi dhe është i detyrueshëm për t'u zbatuar për ta, prej datës së nënshkrimit të kësaj kontrate.